

KËRKESË
Nr. 2619/6, datë 7.8.2020

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i terreneve sportive në “Shkollën Kosova”, në Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim dhe/ose për shkëmbim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak, të llogaritur si:

1. Për pasuritë e llojit “truall” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

2. Për pasuritë e llojit “ndërtesë me funksion banimi” është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, bazuar në shkresën nr. prot. 58091/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Jug.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Tiranë, si dhe në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 76 213 135 (shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e trembëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e pesë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Artan Shkreli

**LLOGARITJET PARAPRAKE PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I TERRENEVE
SPORTIVE NË “SHKOLLËN KOSOVA”, NË TIRANË**

Nr.	EMËR ATËSI MBIEMËR	ZK	Nr. pas.	Sip. e përgj. trualli (m²)	Sip. e prekur trualli (m²)	Çmimi për truall (lekë/m²)	Vlera, truall i prekur (lekë)	Sip. e gjurmës së objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e përgj. ndërtimi e objektit, sipas kartelës (m²)	Sip. e prekur, objekt (m²)		Çmimi për objekt banimi (lek/m²)	Vlera, sip. prekur objekt, shërbimi, me situacion (lek)	Vlera, sip. prekur, objekt banimi (lek)	Vlera e përgj. truall + objekt (lek)	Konfirmim: ASHK Tiranë	Shënime
										Sip. shërbimi (m²)	Sip. banimi (m²)						
1	BP Tagani (Kimete Mehmet Tagani, Arben Sami Tagani, Xhelal Sami Tagani)	8160	2/330-ND	0	0	-	-	110.00	330.00	0.00	330.00	172,198.82	0.00	56,825,609.12	56,825,609.1	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në kartelën e pasurisë, seksioni “Përshkrimi i veçantë” ka shënimin: “Objekt 3-katësh”, dhe në seksionin “E” ka shënimin: “Ndërtesa ngrihet mbi truallin me nr. pasurie 2/330, vol. 47, f. 203”
2	Pronar i pavërtetuar	8160	2/330	234.5	234.5	66,969	15,704,230.50	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0	0	15,704,230.50	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Në kartelën e pasurisë, në seksionin “E” ka shënimin: “Mbi këtë truall ngrihet ndërtesa me nr. pasurie ND-2/330, vol. 49, f. 96”
3	BP Tagani, Saraçi	8160	2/165	36	36	66,969	2,410,884.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	2,410,884.00	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
4	Bashkia Tiranë	8160	2/76	2468.5	10	-	-	748.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
5	Artan Ferid Tagani	8160	2/331	66.5	19	66,969	1,272,411.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	1,272,411.00	Konfirmohet me shkresën nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	
6	Shtet	8160	2/319	242	28	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Shesh
7	Shtet	8160	2/91	893	4	-	-	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0	-	Konfirmohet me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të ASHK-së Drejtoria Vendore, Tirana Jug	Trotuaire
SHUMA PARAPRAKE					331.5										76,213,135		

SHËNIM:

1. Pasuritë e prekura nga projekti konfirmohen me shkresat nr. prot. 5829/1, datë 19.9.2019, nr. prot. 5829/3, datë 23.10.2019, nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020 dhe nr. prot. 5809/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Jug.
2. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
3. Për objektet me funksion banimi, çmimi për llogaritje është marrë çmimi mesatar për objekt banimi vënë në dispozicionin tonë me shkresën nr. prot. 58091/1, datë 5.6.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore, Tiranë Jug.
4. Pasuria nr. 2/287, ZK 8160, në pronësi të bashkëpronarëve Ulqinaku dhe Shahu, e cila preket nga projekti, është hequr nga tabela e llogaritjeve paraprake, pasi në shkresën nr. prot. 966/1, datë 19.5.2020, të ASHK-së, Drejtoria Vendore, Tiranë Jug, konfirmohet pasuri e menaxhuar me leje zhvillimore, në favor të shoqërisë "DAJTI FN".